



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 318 Prot

Tiranë, më 24.09.2014

VENDIM Nr. 338, dt. 08.09.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", (i ndryshuar), **Neni 47**, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.09.2014, mbasi shqyrtoi raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në kuadër të kërkesës për miratimin e projektit "*Porti i Jahteve Kalaja e Turrës*", Komuna Synej, Kavajë, **Subjekti "Finsec" L.T.D.**,

VENDOSI:

- I. Të miratojë projektin "*Porti i Jahteve Kalaja e Turrës*", Komuna Synej, Kavajë, **Faza e I**, sipas kërkesës së **Subjektit "Finsec" L.T.D.**, me kushtet si më poshtë:
- II. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me Subjektin "Finsec" L.T.D të përgatisë një plan veprimi të përbashkët në funksion të evidentimit dhe mbrojtjes së potencialit arkeologjik nëntokësor dhe nënujor, përpara fillimit të punimeve.
- III. Subjekti "Finsec" L.T.D të parashikojë në buxhet mbulimin e shpenzimeve për hulumtimet arkeologjike nëntokësore dhe nënujore përpara fillimit të punimeve, si sondazhe, gërmime arkeologjike shpëtimi, si dhe të një ekspertize për arkeologjinë nënujore.
- IV. Të realizohet mbikëqyrje arkeologjike e vazhdueshme nga specialistët arkeologë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, sipas një plani të detajuar veprimi të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve nga ana e **Subjektit "Finsec" L.T.D.**
- V. Të kryhet studimi arkeologjik për sipërfaqen ku do të zhvillohen fazat vijuese të projektit, përpara shqyrtimit të tyre në KKA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTER**



**SEKRETARI I KKA**  
**RUDINA ZOTO**